



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 29
Prishtinë, më 25. 2. 2009, ora 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujovic, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati, dhe Vezira Emrush – anëtarë.

Ishin të ftuar:

Petrit Zogaj dhe Mexhite Demolli nga *Aksioni qytetar fol – 08*.

Mbledhjen e mbikëqyrën: Lulëzim Demolli (*Koha ditore*), Avdim Hamiti (*Zëri*), Zekri Shabani (*Ekspres*), Mehreme Tahirukaj (RTK-Radio), Ardit Krasniqi (Rokum TV) - Rrezarta Ahmeti (KDI), Blerina Uka (NDI) dhe Nexhat Shatri (Presidenca).

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinatar, zyrtar i lartë.

Për këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
2. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, që ka të bëjë me peticionin për ngritjen e çmimit të energjisë elektrike.
3. Shqyrtimi i raportit të Avokatit të Popullit, lidhur me diskriminimin për të cilin pohojnë R. A. e të tjerë,
4. Të ndryshme.

Ismet Beqiri - Propozoi që Komisioni t'ia fillonte punës me shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës, ndërsa pikat e tjera të mbeten për mbledhjen e radhës, për ne.

Komisioni, sipas propozimit, e miratoi rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

1. **Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, që ka të bëjë me peticionin për ngritjen e çmimit të energjisë elektrike**

Ismet Beqiri - Njoftoi për përmbajtjen e peticionit me 10529 nënshkrime të qytetarëve të Kosovës. Kryesia e Kosovës, me refundimin nr. 03-P-075/k, të datës 18. 2. 2009, e ngarkoi Komisionin për të Drejtat e Njeriut ta shqyrtonte peticionin dhe Kuvendit t'ia

paraqiste rekomandimet lidhur me të. Tha se bazën juridike e ka edhe në nenin 79 të Kushtetutës së Kosovës dhe e ftoi përfaqësuesin e peticionit ta merrte fjalën.

Petrit Zogaj – Sqaroi se peticioni për mbledhjen e nënshkrimeve kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike ka filluar më 26 janar 2009. Për dy javë janë grumbulluar 10529 nënshkrime në mbarë Kosovën. Theksoi se shtrenjtimi i rrymës po bëhet në kohën kur vendi po ballafaqohet me një zhvillim të ulët ekonomik dhe në kohën e krizës financiare, që e ka kapluar gjithë botën.

Ismet Beqiri - Theksoi se çmimi i energjisë elektrike është shumë i lartë në krahasim me standardin e ulët jetësor të kosovareve. Sipas tij, Korporata Energetike e Kosovës, përpos që mbledh para me arkëtimin e faturave të energjisë elektrike, për çdo vit subvencionohet me miliona euro nga buxheti. Prandaj nuk e sheh të arsyeshme ngritjen e këtyre tarifave, por e konsideron goditje të standardit jetësor të kosovarëve, që më se 40 për qind jetojnë në varfëri.

Ibrahim Makolli – Pohoi se me shtrenjtimin e energjisë elektrike KEK-u dëshiron t'i mbulojë humbjet e veta, që sipas tij janë pasojë e keqmenaxhimit të kësaj kompanie. Sipas tij, kjo ndërmarrje është shndërruar në një kancer të shoqërisë kosovare dhe në fatura të energjisë. Tha se mund të shihet se mbi 70% e vlerës së faturave vjen nga gjobitjet për shkak të shpenzimit mbi 200 ose 600 megavat dhe nuk dihet sa paguhet për dënime e sa për shpenzim real të energjisë.

Vezira Emrush - Duke u ndërlidhur me parafolësit theksoi se energjia elektrike në Kosovë aktualisht është trefish më shtrenjtë se në rajonet e tjera. “Ne rajon çmimi i kilovatit është 5 centë, ndërsa në Kosovë 15 centë. Sipas saj KEK-u nuk mund t'i mbulojë humbjet duke e shtrenjtuar energjinë, por mund t'i shesë banesat dhe asetet e tjera që i ka në dispozicion, sepse edhe paratë e buxhetit nuk i mjaftojnë t'i mbulojë ato. Shtoi se Korporata është duke u ballafaquar me keqmenaxhim, sepse nuk arrin t'i arkëtojë detyrimet nga enklavat, që kanë arritur shumën mbi 100 milionë euro dhe nuk paguajnë asnjëherë. Kjo kategori e konsumatorëve, pas lufte, asnjë euro nuk e ka dhënë për energjinë e shpenzuar. Kjo s'ka kurrfarë logjike.

Drita Maliqi – Theksoi se veprimi që u mor lidhur me ngritjen e çmimit do t'u sjellë dëm qytetarëve, që e paguajnë dy herë një shërbim. Ajo veçmas e theksoi muajin janar 2009, kur u bë një shtrenjtim i lartë.

Kjo çështje rregullohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në nenin 79 theksohet: “Nismën për të propozuar ligje, mund ta marrin Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushëveprimtaria e tij/ saj, Qeveria, deputetët e Kuvendit ose më së paku dhjetëmjë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.” Në fund e mbështeti nismën e marrë nga OJQ-të kundër ngritjes së çmimeve.

Sanije Alijaj – U pajtua me diskutimet e parafolësve. Shtoi se veprimi që u mor nga ana e Korporatës, do të ishte kundër objektivave të Qeverisë së Kosovës. Ngritja, sipas saj, nuk ka mbështetje ligjore. Ceku se në këtë mënyrë nuk zhduket varfëria, por thellohet edhe më tepër. Në fund e mbështeti peticionin dhe kërkoi nga deputetët t'u dalin në ndihmë qytetarëve të Kosovës.

Hajredin Hyseni - U pajtua me mendimet e parafolësve dhe e çmoi lartë veprimin e shoqërisë civile për nismën që mori. Tani duket një koordinim ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme. Bëri vërejtje se nuk janë të pranishëm përfaqësuesit e Rregullatorit për Energji Elektrike, që edhe të dëgjonin.

Prof. dr. Nerxhivane Dauti – Peticionin e çmoi lart. Po ashtu tha se është profesional dhe në rregull, madje deri tash për herë të parë e kemi një peticion me 10529 nënshkrime. Duke folur për shkaqet e peticionit shtoi se çdo qytetar i Kosovës është ngulfatur me probleme të rënda sociale dhe me probleme të tjera të krizës globale që po përhapet edhe te ne. Qytetarët po detyrohen t'u drejtohen me shkrim institucioneve dhe kërkojnë t'u mbrohen të drejtat. Theksoi se janari ishte më i rëndi për qytetarët, ngase ka pasur rritje tarifash të energjisë elektrike. Edhe ata qytetarë që s'kishin paguar deri atëherë, paguan madje edhe katër fish. Lidhur me ngritjen e çmimit nuk ka bazë ligjore. Citoi parimin latin: "**Dami facte dabijs**". Në rastin konkret nuk ka fakte dhe as të drejta, por dënim për qytetarët e Kosovës. E mbështeti peticionin dhe tha se qytetari fizik është më i rregullt në pagesën e rrymës sesa subjektet ekonomike që nuk paguajnë. Propozoi që Komisioni të përfshijë rekomandime kundër ngritjes së tarifave të rrymës elektrike. Nuk ka bazë juridike qëllimi i ngritjes së tarifave. Komisioni duhet të kërkojë nga Kryesia e Kuvendit që çështja e tarifave të radhitet si pikë e veçantë dhe të debatohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Të rishqyrtohen faktuarat e KEK-ut, janarit 2009. Nëse KEK-u nuk i rishqyrton vendimet për orët energjisë së shpenzuar, prapë do të kemi ankesa. Nuk do të ishte e udhës që një çështje të shqyrtohet dy herë.

Luljeta Shehu - Nënvizoi se me tarifë të shtrenjtuar janë goditur disa shtresa sociale, siç janë qytetarët e varfër, ata me asistencë sociale dhe ata që kanë pësuar në luftë. Vuri në pah se inkasantët më .Pyeti pse nuk dallohen pagesat e kësaj kategorie qytetarësh dhe të atyre që ushtrojnë biznes. Kërkoj që këtyre familjeve t'u zbriten tarifat e çmimit të energjisë elektrike.

Ismet Beqiri - Duke e përmbyllur mbledhjen theksoi se Komisionit i mbetet t'i mbështetë rekomandimet:

- Në nenin 79 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,
- Në rregullat 41.2, 46 dhe 48.3 të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Në faktin se KEK-u vazhdimisht ndihmohet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës;
- Në faktin se me ngritje të çmimit të tarifës dënohen qytetarët, konsumatorë të rregullt;
- Në mosarkëtimin e borxheve nga KEK-u, te personat juridikë;
- Në faktin se është nënshkruar një peticion nga 10529, që kanë shprehur vullnetin e tyre;
- Në faktin se Rregullatori nuk ka ofruar arsytetime bindëse për ngritjen e çmimit të energjisë elektrike.

Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione plotësisht e mbështet peticionin e organizuar dhe të nënshkruar. Prandaj kundër ngritjes së çmimit të tarifës së energjisë elektrike nxjerr:

R e k o m a n d i m

Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës i rekomandohet që peticioni të radhitet si pikë e veçantë në seancën plenare të radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 30.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri